



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PERMET

Adresa: Shetitorja "Abdyl Frasheri" Permet, Gjirokaster, Albania Web: www.bashkiapermet.gov.al, Email : info@bashkiapermet.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 21 NËNTOR 2022

VENDI: *Salla e Këshillit Bashkiak Përmet*

ORA: *10:00*

Tema e Konsultimit: *Dëgjesë tematike me të rinj e të reja, "Buxheti vendor per Rinine 2023" dhe prioritetet e investimit ne Bashkinë Përmet.*

Baza Ligjore: *Në zbatim të Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, Ligjit Nr.75/2019 "Per Rininë", nenit 1-7, të si dhe ligjit nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 18 dhe VKB-ne Nr.70 date 14.12.2021 "Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se PBA-se 2023-2025 dhe Buxhetin vjetor 2023".*

Pjesëmarrës: *Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha, Përgjegjsja e Projekteve të hujave znj.Kristjana Ibrahim, Përgjegjëse e Integritimit European dhe Rinisë znj.Klaudja Naqellari, Specialist i Rinisë Z.Edjon Maliqi, Drejtori Ekzekutiv INFOCIP (Qendra e Cështjeve për Informimin Publik), Z.Gerri Shella, Rreth 20 nxënës.*

Takimi u hap nga Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha, e cila pas përshëndetjeve dhe falenderimeve, vuri theksin se thelbi i diskutimit për këtë konsultim i dedikohej buxhetit per rinine. Është i pari konsultim që zhvillojmë me të rinjtë dhe jemi posacërisht sot për të dëgjuar kërkesat tuaja e për t'i parashikuar ato në buxhetin e vitit 2023. Dua t'ju falenderoj të gjithëve për angazhimet që ndërmerrni, po ashtu faleminderit Edjonit si specialist që mbulon aktivitetet me

rininë. Ndihem shumë mirë që ju jeni kaq aktivë dhe shpresoj që fillimi i vitit të na gjej me ndërtimin e qëndrës rinore ku jam e bindur që ju do ta menaxhoni shumë mirë. Lajmi që dua të ndaj me ju është se jemi në procedurën e prokurimit për fillimin e ndërtimit të qëndrës dhe shpresojmë që brenda muajit Prill të finalizohet me sukses. Një pyetje që dua t'ju bëj është se deri ku keni shkuar me aktivitetin e planifikuar "Rin Fest".



Minuta: 00-2:40

Dokumentimi Audio-Video Link:

<https://www.youtube.com/watch?v=RluKax578Wo&t=1236s>

Konsultoni për më shumë linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>

Nxënësja Megi Ibrahim: Ai aktivitet do të realizohej nga vitet e treta por nuk e zhvilluan dot.



Minuta: 2:41

Dokumentimi Audio-Video Link:

<https://www.youtube.com/watch?v=RluKax578Wo&t=1236s>

Konsultoni për më shumë linkun:


<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>

Kryetarja e Bashkisë: Jo detyrimisht duhet të zhvillohet nga vitet e treta, mund ta organizoni dhe ju.

Nxënësja Megi Ibrahim: Me shumë mundësi nuk do të realizohet.

Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha: Dua t'ju them se në periudhën kur kam qënë Drejtoresha e Arsimit, të rinjtë kërkonin mundësi financiare që organizonin "Rin Fest", dhe në momentin që flasim jemi në një situatë tjetër, ku bashkia thotë do t'ju mbështes nga ana financiare dhe ju mjafton të organizoni "Rin Fest" apo edhe aktivitete të tjera.

Nxënësja Ester Filipi: Problemi është më tepër tek pjesëmarrja, ishim vetëm 15 veta, si mund të bëhet një aktivitet aq i madh me aq pjesëmarrës.



Minuta: 3:24

Dokumentimi Audio-Video Link:

<https://www.youtube.com/watch?v=RluKax578Wo&t=1236s>

Konsultoni për më shumë linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>

Nxësësja Megi Ibrahim: Ishin vetëm tre cifte, ndërkohë herën e fundit që është zhvilluar ishin 15 cifte.

Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha: Cfarë keni dëshirë që të realizojmë deri në Dhjetor? Ju më kërkua që të parashikonim një buxhet për rinine, tashmë buxhetin e kemi, ju vetëm më thoni çfarë dëshironi të bëni dhe unë jam gati që t'ju përgjigjem. Më thoni cilat janë idetë tuaja, kërkesat tuaja, si ta bëjmë jetën në qytet sa më aktive, që ne t'i planifikojmë edhe për buxhetin tjetër.

Përsa i përket udhëtimit në qytetin e Korcës, do ta realizojmë dhe do të shkojmë "Ditën e Rinisë," datë 8 Dhjetor.

Specialist i Rinisë/Edjon Maliqi: Sa prej jush janë në datën 10 Dhjetor në Tiranë për të marrë pjesë në një aktivitet sportiv?



Minuta: 8:45

Dokumentimi Audio-Video Link:

<https://www.youtube.com/watch?v=RluKax578Wo&t=1236s>

Konsultoni për më shumë linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>

Kryetarja e Bashkisë: Dhe njëherë po jua parashtroj si pyetje do ta realizoni “Rin Fest” deri para Krishtlindjeve? Mund të bëni dhe dicka tjetër unë do ju mbështes. Mendoj ta bëjmë kështu duke qënë se sot është e henë, dua që deri ditën e premte ju të paraqesni një plan për realizimin e një aktiviteti që ju do ta zhvilloni deri në fund të muajit Dhjetor. Ditën e premte Edjoni bashkë me ju dhe vajzat e projekteve do ta diskutoni dhe cfarë realisht do të vendosni të bëni dëri në datën 25 Dhjetor, ditën që janë edhe Krishtlindjet. Ndërkohë në ditën e enjte, datë 8 Dhjetor do të shkojmë në Korcë. Dëshironi që të shkojmë dhe të kthehemi përsëri brenda ditës apo të qëndrojmë? Nëse nuk realizohet dot brenda ditës mendoj të shkojmë një fundjavë. Dhe për këtë do më ktheni përgjigje ditën e premte. Tani dua ide se cfarë të bëjmë me buxhetin per rinine, pres sugjerime dhe kërkesa nga ju.

Drejtori Ekzekutiv/INFOCIP, Z.Gerti Shella: Unë dua t’ju them të rinjve sot se dikur në moshën që ata janë sot une kam qënë shumë i angazhuar, në vitin e dytë në universitet u bëra dhe Kryetar i Këshillit Vendor Shqiptar. Disa nga aktivitet që në bënim në atë kohë ishin këto; në atë periudhë konkretisht ne vitet 95-96, nuk kishte internet, ne formuan një forum, ku mund të shikoheshin disa filma për herë të parë në Shqipëri. Një vit më pas organizuam shkollën e “Eëekend”, ku ditën e premte pasi mbyllin studimet e javës, nuk shkonim në shtëpitë tona, por me autobusin përkatës shkonim në Vlorë. Aty vinin profesorët më të mirë të Juridikut dhe të shkencave sociale si Prof.Arjan Fuga, Prof.Ilir Shina, dhe ajo që nuk ishte e parashikuar në kurrikulën e shkollës ne e mësonim aty si një program ekstra por që të nxiste shumë mendimin kritik. Një program i tretë ka qënë ekspozitat me fotografi dhe padiskutim një nga kurset më interesante për mua në atë kohë ka qënë pjesa sesi të aftësoheshim në ligjërimin publik. Në Tiranë gjetëm miqësi të shpejtë me ambasadat për të sjellë ata rektorë të mirë të retorikës, madje nisëm të bënim dhe një faqe në vitin 1998 kujtoj, ku ishin 100 fjalimet më të mira të demokracisë amerikane. Këto kanë qënë pervojat më të bukura dhe unë jua parashtrova me qëllim që dhe ju të nxisni idetë tuaja. P.sh cfarë mund të bëhet më shumë në Përmet përvec “Rin Fest”, mund të jëtë një ekspozitë për t’i dhënë më shumë ngjyrë realitetit turistik të Përmetit apo edhe për të theksuar një kritikë rinore. Dua t’ju them se ne ishim në Kolonjë para një jave për të diskutuar për buxhetin për rinië, dhe ata ishin me ide të qarta. Po ashtu, për ju sic e tha dhe kryetarja është parashikuar buxheti, dhe mund që ta pyesni kryetaren sesa është shifra e parashikuar e buxhetit dhe a mund të bëhet dicka që ju mendoni me këtë buxhet apo duhet dicka më tepër. Pra, nëse nuk kuptuam kush janë kërkesat dhe cfarë duhet të arrijmë atëherë diskutimi nuk merr vlere. Unë po

ju sjell dhe në vëmendje se neni 7 i Ligjit nr.75/2019 “Për Rininë” parashikon: ku njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për: pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre, krijimin e këshillit vendor të rinisë, organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve, organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve; nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre; financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta; krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë; parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.



Minuta: 9:35

Dokumentimi Audio-Video Link:

<https://www.youtube.com/watch?v=RluKax578Wo&t=1236s>

Konsultoni për më shumë linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>

Nxënësja Megi Ibrahim: Sa është buxheti që ka parashikuar bashkia për rininë për vitin 2023?

Kryetarja e Bashkisë: Po t’ju them që buxheti që kishim parashikuar për vitin 2022 për rininë nuk u zbatua. Ndaj unë doja të dëgjoja ide dhe kërkesa nga ju. Ndaj buxhetin e vitit 2022 mos ta cënojmë dhe nëse ju keni kërkesa të tjera ta rrisim këtë buxhet. Pra nga 5 mln leke të vjetra ta conim në një vlerë më të lartë. Pra gjithë viti 2023 gjithë aktivitetet që kemi me rininë I kemi të mbuluar nga projekti që jem shpallur fitues nga Bashkimi Europian. Unë mendoj që për nga mbështetja financiare do të jetë një nga aktivitetet më të mira.

Z.Gerti Shella: Një aktivitet që mund t’jua sugjerojmë do të ishte dy apo tre senaca trajnimi.. sepse një pjesë nga ju do të jenë votues për herë të parë në zgjedhjet për bashkitë.. ligjet

zgjedhore ndryshojnë në Republikën e Shqipërisë, sa herë ka zgjedhje ndryshohet ligji zgjedhor. Një program i sukseshem është votimi në parlamentet rinore të shkollave në mënyrë për të avancuar axhendën demokratike. Një aktivitet i tretë do të ishte edhe sesi ju edhe me ndihmesën e ekspertëve “bashki të forta”, besoj se ata do ta mikprisnin një kërkesë të tillë, këtu në sallën e këshillit të bënit një cikël diskutimi sesi ju të rëndisni nevojat tuaja dhe të bënit një program të Përmetit për Rininë “Me ju për ju”.

Kryetarja e Bashkisë: Kjo gje realizohet duke përcaktuar një plan, cka do të thotë se këtë muaj do të bëjmë këtë gjë, muajin tjetër një gjë tjetër e kështu me rradhë. Gjithë drejtorinë e projekteve e keni të angazhuar për ta hartuar këtë program. Mendoj se duhet të përfshihemi më shumë për të hartuar një program për rininë, ku nuk do jemi ne hartuesit e programit por te jene vete te rinjte. Edhe për pjesën e udhëtimit në Korçë ne mund të bëjmë një shkëmbim experience me Këshillin Vendor Rinor aty.

Z.Gerti Shella: Korca ka rreth e rrotull atraksione të mrekullueshme, por edhe këtu në zonën tuaj po ashtu, qe te tjeret do te kishin shume deshire per t'i vizituar, por a i keni parë ju vetë me parë ato? Mendoj që nevojat tuaja së pari duhet të kenë një ze, një zë i thot ato. P.sh nje pyetje per ju cuna, ka dicka që ju mendoni se do të ishte mirë të realizohej ne kuadër të këtij buxheti të parashikuar? Pra, cfrarë mendoni se realisht duhet, cfarë mungon, dicka që vërtet ju do të donit ta kishit.

Nxënësja Megi Ibrahim: Dicka që mua më shqetëson është indiferenca që kanë të rinjtë, p.sh kur ne mbledhemi përvec një pjese që është active, pjesa tjetër është shumë indiferente. Edhe nëse organizojmë atë trajnim që ju propozuat do të jemi vetëm ne dhe askush tjetër.

Z.Gerti Shella: Në rregull, por a ka dicka që ju mund të bëni me këtë buxhet që bashkia ka parashikuar posacërisht për ju, në mënyrë që ky buxhet të mos digjet.

Nxënësja Ester Filipi: Të rinjtë sot nuk i tërheqin aktivitet që ne zhvillojmë me “recitime”.. duan dicka ndryshe, p.sh të kishte disa lojëra argëtuese në qënder të qytetit si në Tiranë në periudhën e festave.

Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha: Në rregull, ne do ta zbuqorjmë qytetin, a mund të bëhni ju pjesë e këtij angazhimi?

Nxënësit morrën anagzhmin se do të bëhën pjesë e këtij aktiviteti për të zbukuar qytetin me rastin e festave të fundvitit.

Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha: Do ta mendojmë me kujdes dhe të zgjedhim mënyrat që të duket sa më bukur qyteti, si mund të bashkëpunojmë edhe me biznesin, kjo jo për t'ju kërkuar ndihmë financiare por vetëm për bashkëpunim.

Z. Gerti Shella: Do të ndaj vetëm një shkëmbim përvoja nga qyteti i Beratit, ku kemi qënë para shtatë ditësh. Aty për herë të parë mbledhej Këshilli Vendor Rinor me Kryetarin e Bashkisë, një pjesë e administratës dhe zyra e projekteve. Pati tre kërkesa nga nxënësit, e para ishte nga një vajzë e prirur në fushën e informatikës dhe ajo kërkoi, ndërtimin e një klubi robotike dhe informatike. Kjo kërkesë u mor parasysh nga kryetari dhe u mbajt shënim. Kërkesa tjetër ishte në lidhje me krijimin e një skuadre futbollit dhe voljebollit, dhe kjo kërkesë u shpreh vetëm nga një person, e them këtë për të kuptuar se ju me të drejtë mund të thoni se kjo gjë nuk i bën të lumtur të gjithë të rinjtë e Përmetit por ai foli aty për interesin e vetë konkret.

Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha: Nxënësit i kanë të ngritur ekipet sportive si në rang qyteti ashtu edhe në rang shkolle, në basketboll dhe voljeboll, madje vajzat i kemi fituese të shumë ndeshjeve.

Specialist për Rininë Edjon Maliqi: Ja kemi këtu nxënësin Maldino, pjesë të ekipit të basketbollit cili cdo fundjave shkon në Durrës për stërvitje në një skuadër. Mund të na tregojë madje dhe pak më tepër vetë Maldino për eksperiencën e tij.

Z. Gerti Shella: P.sh disa bluza me logon e Bashkisë Përmet do ju nevojiteshin... Dicka tjetër që kërkuar të rinjtë në Permet ishte se duke qene se aty ka edhe dy shkolla profesionale dhe kërkuar që të aplikohet abonca falas për këta student dhe po ashtu për fëmijët që vijnë nga zona periferike të sigurohet transport publik. Pra, këto jua solla në vëmendje thjesht për ide për t'ju nxitur sadopak mendimin kritik.

Nxënësja Megi Ibrahimi: Dicka që ne kemi folur kur krijuam Këshillin Vendor Rinor, ishte krijimi i grupeve nëpër shkolla, si p.sh klubi i letërsisë apo edhe në fusha të tjera. P.sh Klubi i letërsisë mund të bëjë takime me autorë apo të marrin pjesë në prezantime të ndryshme për të prezantuar krijmtaritë e tyre.

Z.Gerti Shella: Pse nuk i kërkoni bashkisë fonde për të bërë një antologji të poezisë rinore të Përmetit? Pra ju duhen fonde për autorët dhe disa fonde për redaktimin dhe botimin e materialave.

Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha: Keni afat 1-javor për t'u menduar dhe për të sjellë ide.

Nxënësja Megi Ibrahim: Ne kemi dëshirë që pjesëmarrja nga ana e të rinjve, pra nga ana jonë duhet të jetë më e lartë në mënyrë që gjerat të funksionojnë më mirë.

Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha: Unë mendoj se ju duhet t'i bëni pjesë edhe t'i "zgjoni" edhe shokët apo të rinjtë e tjerë jo aktivë, sepse vetëm kështu qyteti mund të ecë përpara. Qyteti nuk ndryshohet vetëm nga Kryetarja, as nga 5 pesë që punojnë në bashki etj..ai ndryshohet vetëm nga të rinjte.

Specilist për Rininë Edjon Maliqi: Ne kemi qënë në një dëgjesë publike bashkë me Kryetarën në Njësinë Administrative, fshati Iljar, dhe mbledhëm të gjithë të rinjë e asaj Njësie Administrative.

Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha: Aty ishin vetëm katër nxënës pjesëmarrës, dy vajza dhe dy djem dhe shumica tjetër ishin të rinj. Dikush punonte pranë njësisë administrative, dikush tjetër do të ndiqte një degë profesionale, një kishte ardhur nga Gjermania dhe mendonte se mund të vazhdonte jetesën këtu, disa të tjera që kishin mbaruar studimet e mesme dhe donin këshilla se çfarë mund të bënin. E them këtë në kuptimin që pati organizim dhe diskutim.

Nxënësja Megi Ibrahim: Po, edhe ne kemi shkoë dhe shoqe nga njësitë e tjera administrative por kur organizohen aktivitete në qytet ata nuk kanë më çfarë të vijnë.

Kryetarja e Bashkisë znj.Alma Hoxha: Kjo mund të jetë një mënyrë bashkëpunimi me bashkinë, ku ju t'i kërkoni Edjonit që pjesë e këtyre aktiveve të jenë dhëe të rinjtë e njësive të tjera administrative dhe në ditën e aktivitetit ne do të vemë në dispozicion një mjet të transportit public për të shkuar t'i marrë dhe ti cojë përseri në destinacionin përkatës.

Z.Gerti Shella: Një analogji me Patosin, Aty që kur e bë konsultimi me Këshillin Vendor Rinor, më bëri përshtypje që përvec njohurive të thelluara të të rinjve kërkuan që bashkia t'i subvencionojë udhëtimin për shkak se jo në cdo fshat ishin të parashikuara linjat urbane. Kjo u

mbajtt shënim nga ana e bashkisë dhe mori zgjidhje. Po e mbyll me një sugjerim, nëse do ta realizoni udhëtimin në qytetin e Korcës, të hartoni një plan veprimi ku janë nevojat, si mund t'i përmbushni duke shkëmbyer ekperienca me të rinjtë e qytetit aty.

Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha: Ateherë, deri ditën e premte do të uleni bashkë me Edjonin dhe Drejtorinë e projekteve dhe do të hartoni një program , çfarë ju nevojitet, si mund realizoni dicka më shumë dhe deri para krishtlindjeve dua të më dorëzoni kalendarin e aktiviteteve. Për pjesën e udhëtimit në Korcë, edhe për aty dua të realizoni një program, sepse do të bëjmë vizitë studimore dhe jo “shëtitje”. Ju pres të realizoni programin dhe vazhdojmë më tej.

Z. Gerti Shella: Një shembull nga Bashkia Rokosvec, para disa ditësh zhvilluan një festë për ullirin dhe aty pati një performancë nga një grup të rinjsh duke shprehur angazhmin e tyre e duke i dhënë një ngjyrë tjetër aktivitetit me profesionalizmin e tyre. Mendoj se dhe ju me angazhimin tuaj do të realizoni aktivitete, programe akoma edhe më të mira.

Nxënësja Megi Ibrahim: Unë do të doja që Këshilli Rinor të kishte një “tendë” të vetën në panairin e ditës së Verës ku ne të krijojmë dicka tonën dhe ta promovojmë.

Z. Gerti Shella: Një gjë tjetër që ju mund ta bëni në shkollën tuaj, është të realizoni një peticion për katër apo pesë çështje që ju duken se duhet t'i jepet prioritet dhe të kërkohet zgjidhje sipas rëndësisë së tyre. Keni buxhet, tregoni aftësitë për ta investuar për ato çfarë ju mungon dhe çfarë ju nevojitet.

Kryetarja e Bashkisë Znj. Alma Hoxha mbyll takimin duke shprehur që cdo gjë do të rezlizohet me sukses.

FOTO-GALERIA E TAKIMIT:



Për të shikuar të plotë takimin konsultativ në audio-video, kliko linkun:

<https://www.youtube.com/watch?v=Lo1D6zf461c>

Për të shikuar të plotë foto-galerinë e takimit konsultativ kliko linkun:









<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-konsultim-publik-per-buxhetin-2023-me-terrinjte-dhe-keshillin-vendor-rinor/>







LISTE-PREZENCA:

Lista e pjesëmarrësve

Konsultim Publik / Degjese ne Bashkiaë Permet

Date e eventit/aktivitetit 21/11/2022

NR	EMER/MBIEMER	PROFESIONI	Bashkia/ NJ.A	KONTAK/ FIRMA
1.	Grita Ngjelo	Nxënëse	Permet	
2.	Megi Ibrahim	Nxënëse	Permet	
3.	Patiana Kreci	Nxënëse	Permet	
4.	Georia Tole	Nxënëse	Permet	
5.	Ester Filipi	Nxënëse	Permet	
6.	Amirhela Beqaraj	Nxënëse	Permet	
7.	Gresilda Manoli	Nxënëse	Permet	
8.	Rshime Qosja	Nxënëse	Permet	

9.	Klejdi Zeiraj	Nxënës	Përmet	
10.	Endri Zejmi	Nxënës	Përmet	
11.	Jomaldino Fekollari	Nxënës	Përmet	
12.	Mario Kamini	Nxënës	Përmet	
13.	Amisa Elmazi	Nxënës	Përmet	
14.	Tea Pasholli	Imfouip/Juistik	Tirane	
16.	Kushjoma Ibrahim	Përgjegjëse e Projektit ID huaja	Përmet	
17.	Klaudja Ciko	Përgjegjëse e Integrit Europian (Kamini)	Përmet	
18.	Edjon Maliqi	Specialist për Rininë	Përmet	
19.				

Hartoi dhe Mbajti kete Procesverbal:

Specialist për Rinine / Bashkia Përmet

Edjon Maliqi



Përgjegjëse e Integritit European për Rininë:

Klaudja Ciko

